



ARGUMENTUM

news opinion analysis

- Ndahet nga jeta
ish-Presidenti i Shqipërisë
Bujar Nishani

- Pse vizita e Bidenit në
Azinë Lindore është në
këmbën e gabuar?

- A Tenfold Geo-Political
"NO" to "Open Balkans"



SHIREEN ABU AKLEH

Zëri i Palestinës u vra, por jehona e saj është e përjetshme!

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Në tre vjetorin e themelimit të kësaj media online, **Argumentum.al** tashmë vjen në versionin e një reviste të përmuajshme të cilën mund ta shfletoni online nga muaji **PRILL 2022**.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në vend, rajon, Europë dhe në botë.

Argumentum.al përpiket të jetë burim

autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle

materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë **Argumentum.al** është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten

Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03-05 IN MEMORIAM

- Presidenti Ilir Meta ka mbajtur fjalimin e lamtumirës në nderim të ish-presidentit Bujar Nishani.
- Ish-kryeministri Berisha pëlqet ndërsa i jep lamtumirën mikut dhe bashkëpunëtorit Bujar Nishani.
- Djali i ish-presidentit Nishani, Ersi Nishani: "Im atë nuk bënte kurrë kompromis për tre gjëra. Për familjen, Zotin e Atdheun!
- Kush ishte Bujar Nishani?

06 ANALIZA E "ARGUMENTUM"

- Shireen Abu Akleh, zëri i Palestinës u vra, por jehona e saj është e përgjeshme!

08 JO VETEM LAJME

- Pse vizita e Bidenit në Azinë Lindore është në këmbën e gabuar?

10 REALPOLITIK

- Po dialogu ku është? Sebe për muhabet! Europa e Re përballë Rusisë së Vjetër! Ok, Zonja Ambasadore!

12 POLITIKA

- Dhjetëvjeçar gërricjesh.

14 FOKUS

- Nga konflikti i Ukrainës tek ndryshimet klimatike, ja çfarë ndodhi në Davos.

17 RAJONI

- Aleksandër Vuçiç betohet për herë të dytë si President: "Detyra ime është që të kujdesem për Serbinë".

23-31 ENGLISH EDITION

- *It's time for Albania to treat seriously strategic partnership not just as 'relics' (Editor's Note).*
- *A Tenfold Geo-Political "NO" "to "Open Balkans" (Dr. Jorgji KOTE).*
- *100th anniversary of diplomatic relations between Albania and US commemorated.*
- *On the Greek calends! Yes, all is okay, but poor Abil passed away! More confusion, little information! Again "No" to Open Balkans! NATO in trouble! Kyiv in, Moscow out! (Dr. Jorgji KOTE)*

Lamtumirë President Bujar Nishani!



sh-Presidenti Bujar Nishani u nda nga jeta në mënyrë të parakohshme, më 28 Maj në moshën 56-vjeçare pasi prej dy muajsh vuajti komplikacionet e infektimit me koronavirus.

Situata shëndetësore e ish-kreut të shtetit u rëndua pas infektimit të tij me COVID-19 dy muaj më parë. Ai vuante nga një sëmundje autoimmune në mëlçi dhe nuk arriti t'i tejkalojë pasojat që virusi famëkeq i kishte lënë në organizëm. Fillimisht, Nishani u shtrua në Senatorium dhe pas rehabilitimit të tij fillestar, ai u rikthye në spital për shkak se simptomat post-COVID i lanë me shenja pneumonie në mushkëri. Gjendja e tij u stabilizua për pak kohë. Por, më pas, ajo u përkeqësua. Më 23 prill, ai u nis drejt Gjermanisë për mjekim, ku edhe dha frymën e fundit. Bujar Nishani lindi më 29 shtator 1966 dhe mandatin presidencial, ai e mori me fillim në 24 korrik 2012 dhe e përmbylli më 24 korrik 2017, ndërsa bëhet presidenti më i ri në moshë që ka ndërruar jetë në Shqipëri.

Qeveria shpalli ditë zie Kombëtare në nderim të presidentit të ndjerë Bujar Nishani datën 2 qershor.

Presidenti Bujar Nishani u përcoll në banesë me një ceremoni shtetërore që u organizua në Presidencë ku personalitete të larta të vendit, Kosovës e Malit të Zi por dhe bashkëpunëtorë të tij e familjarë i dhanë lamtumirën. Per here te fundit në Presidencë, ku ai mbajti postin e kreut të shtetit për 5 vjet, në nderim të Bujar Nishanit u zhvilluan homazhe, nga ku ju dha dhe lamtumira e fundit. I mbështjellë me flamurin kombëtar, i mbajtur nga trupa ceremoniale e gardës e veshur me të kuqe, arkëmorti i ish-Presidentit të Republikës Bujar Nishani u përcoll me një minutë heshtje për në banesën e fundit.

Arkëmorti me trupin e ish-presidentit u shoqërua në këmbë deri te Ura e Lanës, nga një kortezh i gjatë jo vetëm personalitetesh, por edhe njerëzish të thjeshtë, që vlerësuan tek ai politikanin që i mëshonte korrektësisë e qytetarisë edhe në 'fushëbetejën' politike. Trupi i ish-kreut të shtetit do të prehet në varrezat e Sharrës.



Presidenti Ilir Meta ka mbajtur fjalimin e lamtumirës në nderim të ish-presidentit Bujar Nishani

'Familjarë të presidentit Nishani. E nderuar kryetare e Kuvendit Lindita Nikolla. Të nderuar ish presidentë, ish kryetarë të Kuvendit dhe ish kryeministra të Shqipërisë dhe Kosovës. Të nderuar udhëheqës politikë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi që na keni nderuar sot. Të nderuar ambasadorë. Të dashur miq dhe bashkëpunëtorë. Faleminderit për praninë tuaj sot për t'i dhënë lamtumirën Bujar Nishanit. Fundi i papritur lë plot pengje për mundësitë e humbura, për ato që nuk u thanë dhe ato që nuk u bënë dot. Dhimbja e bën të vështirë gjetjen e fjalëve që mund të kurojnë këto plagë njerëzore. Ai që i rrethuar nga dashuria e familjes së prindërve dhe asaj që krijoi më pas me Odetën. Për presidentin Bujar Nishani këto ditë ka pasur vlerësime mëse të merituar. Kanë folur bashkëpunëtorët, miqtë, dashamirësit. Kanë folur shqiptarët edhe miqtë e Shqipërisë. I ardhur në politikë nga FA, ai solli virtytet më të mira të ushtarakëve në jetën politike dhe institucionale të vendit.



Ai e shihte politikën si art dhe besonte se ishte instrument për të sjellë ndryshime. Ai besonte te demokracia dhe shteti ligjor. Presidentit Nishani i peshonte fjalë. Ai çmohej për thjeshtësinë në komunikimin publik. Do mbahet mend për qetësinë, forcën e argumentit. Si kryetar i shtetit ai punoi me përkushtim të radhë në mbrojtje të kushtetutës. Ai punoi për të forcuar frymën e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare në vend. Ai besoi deri në fund te demokracia.

Si president në 100 vjetorin e shtetit shqiptar ai mëshiroi këto parime. Ai ushqente një dashuri të veçantë për Kosovën. Presidenti Nishani pati bashkëpunim me faktori politik shqiptar në rajon. Ai diti të vendosë ekuilibrat në marrëdhëniet institucionale dhe vëllazëror. Sot në ditën e lamtumirës e falenderojmë për modelin që ai solli si shtetar, politika, familjar dhe shtetar dhe shembullor. I paharruar ish presidenti Bujar Nishani', tha Meta.

Djali i ish-presidentit Bujar Nishani Ersi Nishani në fjalimin e lamtumirës për babain e tij në varrezat e Sharrës

“Im atë nuk bënte kurrë kompromis për tre gjëra. Për familjen, Zotin e Atdheun!

“Të nderuar personalitete dhe miq të pranishëm u falënderoj për praninë tuaj na keni lehtësuar dhimbjen sado pak. Im atë për tre gjëra nuk bënte kurrë kompromis për tre gjëra, familjen, zotin dhe atdheun. Familja jonë sot i jep lamtumirën busullës së saj drejtuese, kombi shqiptar i jep lamtumirën një shërbëtorit të përlulur dhe Zotit i shtohet një engjëll në parajsës. Lamtumirë baba!” - u shpreh Ersi Nishani.



Ish-kryeministri Berisha përlotët ndërsa i jep lamtumirën mikut dhe bashkëpunëtorit Bujar Nishani



janë edhe pavdekësia e tij tokësore.

Kështu që, me ne mbetet dhe do jetojë gjithmonë Bujar Nishani, njeriu i ndershëm, qytetari i përgjegjshëm dhe atdhetar, prindi dhe bashkëshorti i dashur e shembullor, shërbëtor i përkushtuar i qytetarëve të këtij vendi, demokrat i flakët dhe guximtar, drejtues i talentuar i Partisë Demokratike, burrështetas fisnik, president i aftë dhe dinjitoz që i dha vendit e kombit në drejtim nder dhe dinjitet të veçantë.

Por përsëri, pas kësaj lamtumire, pas kësaj ndarje të dhimbshme dhe të papritur me ty, secili prej nesh ndjehet më i pakësuar, sepse me ndarjen e trishtë me ty ne kemi humbur një pjesë të çmuar, të dashur, të shpirtit dhe zemrës tonë. u shpreh mes lotesh Berisha.

Sali Berisha u përlot në fjalimin e lamtumirës për ish presidentin Bujar Nishanin. Teksa shprehte vlerësimin për Bujar Nishanin si politikan dhe vlerat e tij si njeri, Berisha tha se gjithmonë do të jetojë pranë tyre ish presidenti si demokrat i flaktë dhe guximtar.

Ti megjithëse largohesh nga ne përgjithmonë, përsëri për sa kohë që ne do të jetojmë, do të mbelesh i gjallë midis nesh me veprat, fisnikërinë, dhuntitë e larta morale, përkushtimin e pakufishëm, shërbimet më të mëdha dhe të çmuara ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve në rrugëtimin e tyre për liri.

Vlerat morale, virtytet, veprat, mirësitë e njeriut



Kush ishte Bujar Nishani?



Bujar Nishani lindi në Durrës më 29 shtator 1966. Studimet e larta i kreu në vitin 1988 në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë. Studimet pasuniversitare në Menaxhimin e Burimeve të Mbrojtjes i përfundoi në vitin 1996 në Kaliforni, Shtetet e Bashkuara. Nishani ka studiuar edhe jurisprudencë në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, ku u diplomua në Drejtësi në vitin 2004. Në vitin 2005, ai mori titullin Master për Studime Evropiane në Shkollën e Studimeve Evropiane të Universitetit të Tiranës.

Karriera e tij profesionale filloi në vitin 1988 si pedagog në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”. Më pas, në vitin 1993 shërbeu si drejtor i Punëve të Jashtme në Ministrinë e Mbrojtjes, për të vazhduar në Departamentin e Marrëdhënieve me NATO-n në Ministrinë e Punëve të Jashtme në vitin 1994. Në vitin 1996 Nishani shërbeu në kabinetin e Ministrit të Mbrojtjes. Në vitin 1997, ai u emërua dhe shërbeu si kryetar i Forumit Ushtarak Euroatlantik.

Karriera politike e Nishanit lidhet me Partinë Demokratike ku u anëtarësua në vitin 1991. Në vitin 2001 u zgjodh sekretar i degës së Partisë Demokratike Tiranë; në vitin 2003 u zgjodh nga lista e kandidatëve të Partisë Demokratike, anëtar

i Këshillit Bashkiak të Tiranës; në vitin 2005 zgjidhet anëtar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike dhe më pas anëtar i Kryesisë së PD-së.

Në korrik të vitit 2005, Nishani, kandidat për Partinë Demokratike, u zgjodh deputet në zonën zgjedhore 34 në Tiranë. Në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2009, ai u zgjodh sërish deputet.

Nga marsi 2007 deri në shtator 2009, Nishani shërbeu si ministër i Brendshëm; nga shtatori 2009 deri në prill 2011 shërbeu si ministër i Drejtësisë dhe më pas, në prill të 2011 ai u emërua sërish në postin e ministrit të Brendshëm, ku qëndroi deri në qershor të vitit 2012, kur u zgjodh nga Kuvendi i Shqipërisë në detyrën e Presidentit të Republikës.

Më 24 korrik 2012 Bujar Nishani u zgjodh President i Republikës së Shqipërisë dhe shërbeu në këtë pozitë përgjatë një mandati të plotë deri në vitin 2017.

Nishani ishte njohës i mirë dhe i rrjedhshëm i gjuhës angleze. Ai është i martuar dhe pati dy fëmijë.

Ai u zgjodh president i vendit në moshën 46-vjeçare, duke u bërë kreu më i ri i shtetit në Shqipërinë pluraliste.

Lamtumirë Zoti President!

SHIREEN BU AKLEH

Zëri i Palestinës u vra, por jehona e saj është e përjetshme!

Shireen, për çdo gazetar palestinez dhe për çdo gazetar arab, është një model që e humbëm sot," tha gazetari i Al Jazeera, Tamer Mishal. "Fotografitë tragjike që pamë në rrjetet sociale, të qëlluara në kokë, tregojnë se ato erdhën nga një snajper izraelit i cili qëllloi një plumb direkt në drejtim të saj."

"Deri në sekondën e fundit, Shireen Abu Akleh ishte profesionist dhe këmbëngulës," shtoi ai.

Mesazhi i fundit që Abu Akleh i dërgoi Al Jazeera-s ishte një email në orën 6:13 të mëngjesit, ku ajo shkruante: "Forcat okupuese sulmojnë Jenin dhe rrethojnë një shtëpi në lagjen Jabriyat. Rrugës për atje do t'ju sjell lajme sapo të bëhet e qartë fotografia."

Shteti i Palestinës dënoi në termat më të ashpër vrasjen e dhunshme të Izraelit dhe shënjestrimin e qëllimshëm të gazetares veterane të Al-Jazeera, Shireen AbuAqla, në kampin e refugjatëve Jenin.

"Vrasja e Shireen nga Izraeli është pjesë e luftës dhe nxitjes së tij të mirë-dokumentuar dhe të pranuar gjerësisht kundër gazetarëve palestinezë dhe lirisë së shprehjes dhe shtypit. Izraeli dhe zyrtarët e tij, haptazi dhe publikisht, i shpërblejnë ushtarët e tyre për vrasjen e palestinezëve, duke përfshirë gazetarët, me pandëshkueshmëri të plotë dhe një ndjenjë të guximshme imuniteti", thuhet ndër të tjera në reagimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Gazetarja veterane palestineze Shireen Abu Akleh u vra nga një armë zjarri në kokë mëngjesin e 11 majit 2022 ndërsa raportonte nga Jenin, një qytet palestinez në Bregun Perëndimor. Abu Akleh po mbulonte një bastisje që po kryhej nga Forcat e Mbrotjtjes izraelite (IDF). Ishte një nga disa bastisje që ushtria izraelite ka kryer në Jenin, disa prej tyre vdekjeprurëse, mes trazirave në rritje muajt e fundit.



dhe e Mërgimtarëve të Shtetit të Palestinës.

Shireen AbuAqla është një tjetër viktimë e mosveprimit të qëllimshëm të komunitetit ndërkombëtar për ta mbajtur Izraelin përgjegjës për krimet e tij të vazhdueshme. Krimet e luftës dhe terrorizmi i Izraelit duhet të ndalen. Të lejosh vrasjet mizore të gazetarëve palestinezë nga Izraeli të kalojnë të pakontrolluara do të thotë të sanksionosh vrasjen e gazetarëve.

Ndërsa kanë dhe një thirrje për gjithë gazetarët në botë që të ekspozojnë krimet e Izraelit, përfshirë krimet kundër gazetarëve. Prokurori i Gjykatës Ndërkombëtare Penale duhet të hapë men-

jëherë dhe urgjentisht një hetim për krimet e Izraelit kundër gazetarëve dhe personelit të medias.

I dërguari i OKB-së kërkon përgjegjësi për vrasjen e Abu Akleh

I dërguari i posaçëm i OKB-së për Procesin e Paqes në Lindjen e Mesme, Tor Wennesland, ka dënuar vrasjen e Abu Akleh në Bregun Perëndimor të pushtuar.

"Dënoj fuqishëm vrasjen e gazetares së Al Jazeera-s, Shireen Abu Akleh, i cili u qëllua me zjarr të vërtetë këtë mëngjes ndërsa mbulonte një operacion të forcave izraelite të sigurisë në Jenin, në Bregun Perëndimor të pushtuar", shkroi Wennesland në Twitter.



“Unë bëj thirrje për një hetim të menjëhershëm dhe të plotë dhe që përgjegjësit të mbajnë përgjegjësi. Punonjësit e medias nuk duhet të jenë kurrë në shënjestër.”

Giles Trendle, drejtori menaxhues i Al Jazeera, tha se rrjeti ishte “i tronditur dhe i pikëlluar” nga vrasja e Abu Akleh.

Trendle kujtoi se një ndërtesë që strehon zyrat e Al Jazeera, si dhe organizata të tjera mediatike, duke përfshirë agjencinë e lajmeve Associated Press, u bombardua më pak se një vit më parë gjatë sulmit të Izraelit në Rripin e Gazës. “Ne kemi pasur një histori në të gjithë botën, por veçanërisht në këtë rajon, ku kemi pasur tragjedi,” tha ai, duke bërë thirrje për një hetim transparent të vrasjes së Abu Akleh.

“Si gazetarë, ne vazhdojmë. Misioni ynë është të vazhdojmë. Ne nuk do të heshtim pavarësisht përpjekjeve për të na heshtur”, tha gjithashtu Trendle.

“Misioni ynë është gjithmonë të vazhdojmë të informojmë botën se çfarë po ndodh. Dhe kjo është më e rëndësishme ndonjëherë.”

“Vrasja për se dyti” e Shireen... dhunimi i arkmortit gjatë funeralit të saj

Mënyra e vdekjes së saj dhe

përçarja pasuese e dhunshme në funeralin e saj, kur policia izraelite e armatosur me shkopinj sulmoi mbajtësit që mbanin arkivolin e saj, tërhoqi një dënim të gjerë ndërkombëtar të Izraelit. Funerali i saj u ndoq nga dhjetëra mijëra palestinezë dhe ishte një nga funeralet më të mëdha të mbajtura në Jerusalem.

Policia izraelite shtyhu dhe rrahu pjesëmarrësit në funeralin e gazetares së vvarë të Al Jazeera, Shireen Abu Akleh. Për shkak të ndërhyrjes së policisë, personat që mbanin arkivolin e gazetares për pak kohë e rrëzuan atë. Funerali i gazetares, Shireen Abu Akleh, u shndërrua në shfaqjen ndoshta më të madhe të nacionalizimit palestinez, që është parë në kohët e fundit.

Në funeralin e gazetares, mijëra persona valëvitën flamurin palestinez dhe brohoritën “Palestina! Palestina”. Ky funeral konsiderohet më i madhi në Jerusalem, qëkur Faisal Husseini, një lider palestinez, vdiq më 2001.

Para varrimit, një turmë e madhe u mbledh për të përcjellë arkivolin e saj nga një spital në lindje të Jerusalemit deri te një kishë katolike pranë Qytetit të Vjetër. Shumë prej pjesëmarrësve kishin flamuj palestinezë dhe turma filloi të brohoriste “Ne sakrifikojmë shpirtin dhe gjakun tonë për ty, Shireen”.

Pas kësaj, policia izraelite ndërhyri duke shtyrë të pranishmit. Policia më pas filloi të godiste të pranishmit, ku një person nga goditjet humbi kontrollin dhe lëshoi arkivolin e gazetares në tokë. Policia grisi flamujt palestinezë dhe hodhi shok-bomba për të shpërndarë të pranishmit.

Vëllai i Abu Akleh, Tony, tha se këto skena “dëshmuuan se raportimet e Shireen dhe fjalët e singerta... kishin një ndikim të madh”.

Gazetarja e Al Jazeeras, Givara Budeiri, tha se kjo shtypje e policisë ishte sikurse Abu Akleh të vritej sërish.

“Duket se zëri i saj nuk ka heshitur”, tha ajo.

Jerusalemi Lindor, që është shtëpi e vendeve të shenjta të hebrenjve, myslimanëve dhe të krishterëve, u pushtua nga Izraeli në luftën e Lindjes së Mesme më 1967. Izraeli thotë se i gjithë qyteti është kryeqyteti i shtetit dhe ka aneksuar pjesë në lindje, por komuniteti ndërkombëtar nuk e njeh si kryeqytet të Izraelit.

Palestinezët pretendojnë se Jerusalemi Lindor do të jetë kryeqytet i shtetit të tyre të ardhshëm. Izraeli në vazhdimësi shtyp shfaqjen e mbështetjes për shtetësinë palestineze.

Pse vizita e Bidenit në Azinë Lindore është në këmbën e gabuar?

Nga Victor Gao

Pas vizitës së tij në Republikën e Koresë (ROK), Presidenti i SHBA Joe Biden po viziton Japoninë dhe është i etur për të nxitur më shumë armiqësi kundër Kinës në Azinë Lindore dhe në rajonin Azi-Paqësor në tërësi, duke u fokusuar në QUAD (gjoja një aleancë kundër Kinës), çështja e Tajvanit dhe propozimi i një “Kuatrid Ekonomik Indo-Paqësor” (IPEF), gjoja që synon të përjashtojë Kinën.

Kina është ekonomia më e madhe në botë për nga barazia e fuqisë blerëse (PPP), dhe ekonomia e dytë më e madhe në botë nga llogaritja zyrtare e kursit të këmbimit, dhe është kombi më i madh tregtar me më shumë se 130 vende dhe rajone në botë, duke përfshirë shumicën e vendeve në rajonin Azi-Paqësor.

Përjashtimi ekonomikisht i Kinës në botën e sotme është një akt marrëzie, çmendurie dhe kotësie, dhe do të dëmtojë më shumë sesa të ndihmojë interesat themelore të popullit amerikan. Sipas të gjitha vlerësimeve të arsyeshme, Kina do të kalojë SHBA-në si ekonomia më e madhe para fundit të kësaj dekade. Askush nuk mund të ndalojë vrullin e rritjes ekonomike të Kinës. Në fakt, çdo përpjekje për t'i privuar popullit kinez të drejtën e zhvillimit ekonomik do të jetë ndoshta krimi më i madh kundër njerëzimit dhe do të dështojë keq.

Ajo që ka rëndësi në Azinë Lin-



dore, në rajonin Azi-Paqësor dhe në botë në tërësi është paqja, rritja dhe zhvillimi, në vend të konfrontimit, luftës ose rifilimit të një tjetër Luftë të Ftohtë. Kina është një forcë kryesore për paqen dhe zhvillimin në botë sot, dhe Shtetet e Bashkuara do të duhet të shkojnë mirë me Kinën, në vend që të përballen me të.

Thelbi i vërtetë i çështjes së Tajvanit është lufta e papërfunduar civile në Kinë në fund të viteve 1940, e cila çoi në krijimin e Republikës Popullore të Kinës (PRC) në territorin kinez në vitin 1949, dhe ikjen nga kontinenti në provincën e Tajvanit të Kinës. qeveria e atëhershme nacionaliste e kryesuar nga Chiang Kai-shek në 1949.


Deri më sot, më shumë se 180 vende në botë dhe të gjitha organizatat kryesore ndërkombëtare në botë pranojnë se ekziston vetëm një Kinë, dhe Tajvani është pjesë e Kinës, dhe PRC është përfaqësuesi i vetëm legjitim i Kinës. Shtetet e Bashkuara e bënë një njohje të tillë në vitin 1979 për të vendosur marrëdhënie diplo-

matike me PRC, me parakushtin e vendosur nga PRC për tërheqjen e trupave amerikane nga rajoni i Tajvanit, duke shfuqizuar “marrëdhëniet diplomatike” dhe “traktatin e mbrojtjes” të SHBA me Tajvanin.

Qëndrimi i SHBA-së sot në lidhje me Tajvanin është plot me paqartësi të qëllimshme që synojnë të mashtrojnë popullin amerikan në fillim, duke mashtruar ata në Tajvan që duan të promovojnë “pavarësinë e Tajvanit” dhe duke mashtruar të gjithë botën në lidhje me statusin e vërtetë ligjor të Tajvanit, i cili është një pjesë e Kinës.

Vendimmarrësit amerikanë mund të besojnë se nxitja e konfrontimit ushtarak nëpër ngushticat e Tajvanit mund të jetë një mënyrë e sigurt për të shkaktuar gjakderdhje që përfshin Tajvanin dhe për të penguar zhvillimin e vazhdueshëm paqësor të Kinës.

Ajo që SHBA po bën, në fakt, mund të provokojë ringjalljen e luftës civile të papërfunduar,



e cila është thjesht një çështje e brendshme kineze, dhe as SHBA-ja e as ndonjë vend tjetër i huaj nuk ka ndonjë justifikim legjitim për t'u përfshirë në një ringjallje civile. luftë në Kinë. SHBA gjithashtu mund të keqlllogarisë plotësisht situatën, sepse njerëzit në të dy anët e ngushticës së Tajvanit janë i njëjti popull kinez dhe bashkimi i Kinës në emër të një Kine të bashkuar është mega-trendja e botës sot.

Asnjë president i SHBA-së nuk ka ndonjë justifikim ligjor apo mirësjellje morale për të dërguar ushtarë amerikanë për të luftuar në luftën civile të ringjallur në Kinë, të cilën qeveria amerikane mund të provokojë me skema ogurzi dhe të rrezikshme. Asnjë vend tjetër në botë nuk do t'i shërbente interesit themelor të popullit të vet për të luftuar në luftën civile të ringjallur në Kinë, të cilën qeveria e SHBA po provokon në

mënyrë aktive dhe të egër.

Për sa i përket QUAD-it, të presësh që kombi i madh i Indisë mund të rrëmbehet në karrocën e luftës së Shteteve të Bashkuara kundër Kinës, është një keqkuptim i plotë i pavarësisë së Indisë si një vend i madh.

Për mijëra vjet, Kina dhe India u bashkuan me njëra-tjetrën në mënyrë paqësore. Mosmarrëveshjet territoriale që ekzistojnë sot midis dy vendeve u krijuan nga asnjëri prej tyre, por nga kolonistët perandorakë britanikë në Indinë Britanike.

Kombi kinez dhe kombi indian, dy super-popullatat e vetme në botë, me siguri do të kenë mençuri, guxim dhe vizion të mjaftueshëm për të kapërcyer skemat konspirative të kolonistëve britanikë kur ata sunduan popullin e madh indian si një nën-klasit të dytë. specie dhe

planifikuan të pushtojnë dhe pushtojnë Rajonin Autonom të Tibetit të Kinës.

Sa i përket Japonisë, ajo ka ende mosmarrëveshje territoriale me Rusinë, ROK-un, Kinën dhe rajonin e Tajvanit të Kinës, pavarësisht dorëzimit të saj të pakushtëzuar në vitin 1945. Qeverisë japoneze duhet t'i përcillet një mesazh i vendosur dhe i ashpër se Japonia nuk lejohet të posedojë armë ose armë sulmuese të çdo lloji të shkatërrimit në masë në botë sot, që të mos pësojë pasoja të tmerrshme.

Mënyra më e mirë për Japoninë për të rifituar sovranitetin e saj normal dhe të plotë është që të angazhohet plotësisht për paqen dhe të betohet përherë për luftë të çdo lloji. Do të jetë kundër interesit themelor të popullit japonez që të agjitojë për luftë dhe të betohet për paqe./CTGN-

Po dialogu ku është? Sebe për muhabet! Europa e Re përballë Rusisë së Vjetër! Ok, Zonja Ambasadore!

REALPOLITIK “FLASH” NO. 45 | 3 - 16 MAJ 2022

DR. JORGJI KOTE

1. Po dialogu ku është? Kjo pyetje shtrohet dhe pas 4 Majit kur në Berlin, Kancelari i ri gjerman Olaf Scholz bëri bashkë Vuçiç me Kurtin, në prani të Ndërmjetësuesit të BE-së Lajcak dhe atij gjerman, Sarrazin. Ishte demarshi i parë i Kancelarit Scholz për të trajtuar një temë që ka hyrë në qorrsohak. Me ndërmjetësues, nga BE-ja, SHBA-ja, Gjermania, Britania e Madhe, plot fjalë e premtime, po dialogu s’duket gjëkund; ka vetëm “tërheqje litari”. Sepse dialogut i mungon tabani, baza, dhe mjedisi i nevojshëm, jo në kuptimin e tryezave, pijeve dhe specialiteteve kulinare europiane, por mjedisi politik, dmth mirëkuptimi dhe mirëbesimi midis dy palëve të interesuara. E çfarë dialogu mund të presësh kur Vuçiç, pa e “tretur” ende mirë darkën e Borrell më 11 Maj mbledh Këshillin Kombëtar të Sigurisë; sepse Kosova në të drejtën e vet si shteti i pavarur kërkon antarësimin në Këshillin e Europës. Ndërkohë, Beogradi çirret e bërtet, madje e fton Prishtinën në “Ballkanin e Hapur”. Çfarë hipokrizie dhe demagogjie! Dhe ne i “mbajmë iso” dhe ia themi rezervat me gjysëm zëri!! Kur Serbia nuk njeh krimet, nuk denjon të njohë pavarësinë e Kosovës, dhe me shumë “nuk-e” të tjera. Kur ajo vazhdon, pa e “bërë qejfin qed-



er”, të luajë lojën e karrikes muzikore dhe tani, pas agresionit rus në Ukrainë, i vetmi vend që nuk bashkohet me sanksionet.

Ja pse, me shumë keqardhje e themi se nuk shihet asnjë rrugëdalje dhe dialogu mund të kthehet në “tërhiq e mos e këput”, pavarësisht ec e jakeve nga të gjitha anët; e dëshmoi dhe dështimi i tij më 13 Maj në Bruksel për targat.

2. Sebe për muhabet” ishte në kuptimin e mirë të fjalës Darka Informale e shtruar nga Për-

faqësuesi i Lartë i Politikës së Jashtme të BE-së, Josep Borrell më 11 Maj për 6 liderët e Ballkanit Perendimor dhe Takimi i Ministrave të Jashtëm më 16 Maj në Bruksel. Evente të tilla janë bërë “si simitet” për nga shpeshtësia, por nga shija që lenë, ku t’i gjesh simitet tona! Idea e paraardhëses Mogherini ishte e mirë, të mblidhen 6 liderët, në qetësinë e Brukselit, larg rrokopujës ballkanike, nën aromën e pijeve dhe delikatesave belgo/europiane, të flasin pa protokoll dhe miqësisht për hal-

“

10 geopolitical miscalculations with catastrophic costs for Ukraine, Europe and Russia were made by Putin. Both at home and abroad, for today and tomorrow. His mistakes remind us of Bonaparte, who after the invasion of Spain was trying to justify himself saying that after all he had not committed any crime; but the great Talleyrand gave him with great concern the emblematic answer “No, Your Majesty, it is even worse, you have committed a mistake”.

let e rajonit. Për t'i çelur rrugën diskutimeve dhe veprimeve zyrtare. Mirëpo, në këto vitet e fundit është tepëruar aq shumë më to, sipas parimit “korr e mos shij” sa që e kanë humbur kuptimin, interesin dhe jehonën publike. Edhe verën e kaluar u zhvilluan të paktën 10 samite rajonale, në atraksionet më të bukura turistike, në freskinë e detit, liqenit dhe alpeve. E megjithë këtë atmosferë joshëse dhe gazmore, jo vetëm nuk ka rezultate të prekshme, por gjërat po shkojnë “nga shiu në breshër”. Së shpejti, bashkë me çeljen e sezonit të ri turistik, do të rifillojë “gara” për këto samite, që shpresojmë të jenë më shumë se sebeb për muhabet.

3. Europa e Re përballë Rusisë së Vjetër u shfaq më 9 Maj, Ditën e fitores kundër nazi-fashizmit dhe 72 Vjetorit të Deklaratës “Schuman” që shënon dhe Ditën e Europës. Kështu, në Parlamentin European në Strasburg, Presidenti francez, Macron, në praninë dhe me mbështetjen e Presidentes së Komisionit European, Ursula von der Leyen, dhe si Kryesues i radhës i BE-së shpallosi vizionet për një Europë cilësisht të re, që t'i bëjë ballë sfidave serioze madhore në të gjitha fushat, veçanërisht në politikën e jashtme dhe të sigurisë, energjitikë, shëndetësi, bujqësi, transport, mirëqenien

sociale, etj.

Sipas Macron, në këtë arkitekturë të re europiane vend të veçantë do të zëjë krijimi i “Bashkësisë së re Politike të Zgjeruar Europiane”. Për këtë kemi shkruar hollësisht në analizën “Qershori europian plot pritshmëri dhe të panjohura” te [ARGUMENTUM](#).

Më 9 Maj, përfundoi dhe konsultimi qytetar në të gjitha vendet antare mbi të ardhmen e BE-së; me mbi 3000 propozime që përfshijnë dhe rishikimin e traktateve të BE-së, etj. Gjithashtu, ndryshe nga sa pritej, Europa dhe Perëndimi me SHBA-të në krye shprehu dhe po realizon në praktikë kohezion politik, ekonomik, publik dhe ushtarak; Europa po bën një revolucion të vërtetë në politikën e jashtme dhe të sigurisë ndërkombëtare; po ashtu, ajo po shfaq bujarinë, ndihmën dhe solidaritetin me popullin hero të Ukrainës dhe mesazhet për pranimin e saj si kandidat në BE bashkë me Gjeorgjinë dhe Moldavinë.

E kundërta ndodhi në Moskë ku u zhvillua tejet e sforcuar Parada tradicionale e 9 Majit. Më 24 Shkurt, kur Putin urdhëroi fillimin e agresionit ndaj Ukrainës, kishte menduar që 9 Maji 2022 t'i ngjante apo dhe t'ia kalonte Paradës madhështore të vitit 1945. Mirëpo, dështimet

e shumta dhe të vazhdueshme në Ukrainë e zbehën së tepërmi shkëlqimin e saj. Kjo u duk në atmosferën, përmasat, armët e ekspozuara dhe fjalimin e Putinit, ku sukcesi nuk ndihej askund, se për triumf as që bëhej fjalë! Më në fund, ai pranoi humbjet e shumta me ngushëllime për familjet e viktimave. Ndërkohë, motivimi i shtrisë ruse në Ukrainë nuk krahasohet me atë të Ushtrisë së Kuqe.

Shkurt hesapi, ishte paradë humbësish dhe ngushëlluese për “shpirtrat e trazuar”, shumë larg entuziazmit triumfues të 9 Majit 1945! Por keq po shkon puna dhe në fusha e tjera. Ekspertët dhe të dhënat flasin për “ekso-din e Putinit”. Gjatë 4 muajve të parë të këtij viti janë larguar nga Rusia 3,8 milion vetë, vetëm në Prill 400.000 vetë! 60 për qind janë nën moshën 35 vjeç dhe 1/3 ekspertë të teknologjisë së lartë; 57 për qind e tyre kanë punë të sigurt dhe paga të kënaqshme, megjithatë, e shohin se nuk jetojnë dot më në Rusi. Ndërkohë, imazin ndërkombëtar i Rusisë ka rënë për tokë! Ndërsa Europa dhe Ukraina, pas Kievit dhe Charkivit, më 14 Maj fitoi dhe Eurovizionin në Torino!

5. OK, Zonja Ambasadore Juri Kim për intervistën më 12 Maj nga çdo anë. E balancuar, me përmbajtje, korrekte, sqaruese dhe informuese! Kësisoj, shuajti jo pak hamendësime, rezerva dhe kritika ndaj saj. Vërtet qëndrimet e saj janë zyrtare, por dihet se Ambasadori i një vendi, sidomos i SHBA-ve, ka hapësirë të madhe veprimi, në mënyrë që mesazhet të jenë përherë korrekte, pa krijuar kundërshti e debate në publik. Pastaj, Qendra udhëzon Çfarë të bëhet, ndërsa Ambasadori vendos SI bëhet një veprim diplomatik. Së fundi, vizita e Pompeo në Tiranë ishte lëvizje e mençur që flet më shumë se fjalët.



DHJETËVJEÇAR GËRRICJESH

Përktheu për Argumentum Xhelal FEJZA

Duke besuar se Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit është e pandryshueshme si Bibla, me duart e lidhura nga preambula e Kushtetutës, pushteti serb vazhdon të mbrojë iluzionin mbi shtetin e tij sëbashku me Kosovën. Hendeku absurd mes legjislativitetit juridike, emocioneve, historisë dhe besimit fetar nga njëra anë dhe realitetit nga ana tjetër, po shfaqet në dritë të diellit – gjë të cilën Beogradi zyrtar nuk dëshiron ta shohë. Deri kur sovraniteti kombëtar do të vazhdojë të ekzistojë vetëm në hartat e prognozës së motit në TV, ndërsa të gjitha të dhënat e tjera zyrtare shënohen si “Serbia pa Kosovën dhe Metohinë”?

Është histori e gjatë. Antagonizmi serbo-shqiptar i ka rrënjët që në kohën e luftërave ballkanike kur morën flakë nacionalizmat dhe frustracionet rajonale. Populli shqiptar në vitin 1913 u nda në dy pjesë: në shtetin e sapokrijuar të Shqipërisë dhe në Kosovë, e cila tani synon bashkimin me shtetin amë dhe nuk harron kurrësi atë për të cilën në Serbi heshtet në mënyrë sistematike: masakrat kundër shqiptarëve gjatë këtyre luftërave si “realizim i përбетimit të shenjtë”.

Në periudhën pas vitit 1945, kohë në të cilën nuk dihej nëse Kosova do ti përkiste Shqipërisë apo Jugosllavisë, ky territor i krijoi shumë probleme shtetit të përbashkët.



Kryengritjet në Kosovë u shtypën në mënyrë brutale, gjë e cila çoi në atë që në vitet 1980 në Serbi, 80 përqind e të burgosurve politikë ishin shqiptarë të cilët me durim dhe në mënyrë të organizuar prisnin rastin e tyre të dytë.

Shanset për një kthim në jetën e përbashkët u zhdukën përfundimisht në vitin 1999, por pushteti serb, duke u mbështetur te Kushtetuta harroi, faktin se shqiptarët e Kosovës nuk duan të jetojnë në Serbi. Pasi që me ndërveprimin e Kishës u ndezën ndjesitë patriotike të qindra mijëra serbëve të cilat nuk dinë pothuajse asgjë dhe nuk e kanë parë asnjëherë “Jerusalem serb”, politikanët filluan ta pranojnë Serbinë qiellore si realitet. Nëpërmjet kësaj, garniturat në pushtet kamufluan realitetin dhe as që guxuan tu thonë qartë qytetarëve atë që shumica e tyre e mendojnë privatisht.

Ndërsa shihnin me bisht të syrit

nga Rusia si mbrojtëse e shenjtë e Kosovës serbe, maksimumi i kuraos u reduktua në pranimin për të hyrë në bisedime për të cilat është e vështirë të thuhet nëse i ka më pa dëshirë pala serbe apo ajo kosovare. Doli qartë se koha, ajo që për të tjerët është më e rëndësishme, për dialoguesit kishte më pak rëndësi. U humb një dhjetëvjeçar, ndërsa Beogradi dhe Prishtina janë pothuajse në pikën zero sepse Marrëveshja e Brukselit e viti 2013 u shndërrua në një abstraksion dokumentar, ndërsa dialoguesit shkëmbejnë me shumë oreks akuzat duke shpjeguar përse ndodhi kështu.

Ruajtja e status kuosë në raportet reciproke, krahas vlerësimit real se drejt përparimit në frontin e Brukselit nuk ka asgjë të re në një të ardhme të afërt, do të thotë se problemi kosovar do të intensifikohet në përputhje me ashpërsimin e raporteve mes Lindjes dhe Perënd-

dimit, Rosisë dhe ShBA-ve

Nuk është rastësi që Vladimir Putini, para pak kohësh shpjegoi se pavarësia e republikave popullore të Donjeckut dhe Luganskut, në Lindje të Ukrainës, është shpallur sipas shembullit të Kosovës. Dy fuqi të mëdha mbështeten në politikën e standarteve të dyfishta kur u nevojitet, ndërsa eksperiencat mëson se ato shumë lehtë bëjnë tregti me vendet e tjera.

Është angazhuar edhe pala tjetër- duke bërë presione. Nuk ka më përralla me “normalizim”. Nga Uashingtoni deri në Berlin këshillojnë në mënyrë ekskluzive: njohje e ndërsjellë. Secili e ka të qartë se Prishtina, e inkurajuar nga Perëndimi, ka kërkuar antarsim në Këshillin e Europës dhe se janë bërë punimet përgatitore që të sigurohet shumica prej dy të tretash në Komitetin e ministrave. Aleksandër Vuçiçi thotë se do të ndjekë e vëmendje se cili nga 46 antarët e Këshillit do të mbështesë Kosovën, por nuk do të ketë kurrfarë befasi, në mënyrë të veçantë tani që është pezulluar antarsia e Rosisë në Këshill, ose më mirë të themi qëkur Moska është larguar vetë.

Ministri i punëve të brendshme Aleksandër Vulin bën sikur mezi pret që Kosova të hyjë në Këshillin e Europës në mënyrë që pastaj Serbia të shpallë “neutralitetin politik”, gjë që do të thotë se do të heqë dorë nga Bashkimi European dhe Perëndimi i keq.

Akuzohet Prishtina se po shkel Marrëveshjen e Uashingtonit. Sikur ta kishin lexuar me vëmendje, do të shihnin se në atë dokument ekziston klauzola që i kufizon me një vit detyrimet e Beogradit për të ndaluar fushatën e heqjes dorë nga njohjet e Kosovës dhe detyrimi i Prishtinës për të mos kërkuar antarsim në organizatat ndërkombëtare. Këtij neni ka kaluar afati.

Nëse hyn në Këshillin e Europës, Kosova është një hap larg antarsimit në Organizatën e Kombeve të

Bashkuara gjë të cilën vërtetë Rusia mund ta bllokojë në Këshillin e Sigurimit, por vështirë se mund ta bëjë këtë në Asambleenë e Përgjithshme, kur ShBA dhe BE do të përpiqen të sigurojnë një shumicë të mjaftueshme.

Për pasojë Serbia do të gjendet para murit, duke rrezikuar kështu që mbetet e izoluar në shoqërinë e Rosisë, Kinës, Kubës ose Venezuelës, gjë që nuk është fort popullore këtyre ditëve. Fakti që pesë antare të BE-së mund të jenë kundër nuk do të mund të ndryshojë shumë gjëra. Perëndimi është mësuar të jetojë me këtë fakt i cili, sikurse po shohim, nuk e pengon të nisë iniciativat të reja të cilat duhet ta legalizojnë pavarësinë e Kosovës. Hapësira e Beogradit për manovrim do të ngushtohet akoma më shumë. Çfarë duhet bërë nëse Kremli në një moment e përfshin Kosovën në arranzhimet e marrëveshjes me Perëndimin pas përfundimit të luftës ukrainase? A u dashka që Serbia të presë që Rusia ta njohë Kosovën e pastaj të esëlllohet? Serpse kjo nuk është fantazi shkencore por politikë reale.

Përsa u përket serbëve në Kosovë, u duhet lënë atyre në dorë që të vendosin për fatin e tyre dhe nuk ka përse të luajnë sipas toneve nga Beogradi. Le të përfshihen në jetën e atjeshme, ndërsa shteti amë të vazhdojë tu ndihmojë në masën që kjo nuk është përzierje në punët e brendshme të një shteti tjetër. E njëjta gjë vlen edhe për serbët në Mal të Zi, ose serbët në Republikën Srpska. Beogradi, në marrëveshje me Perëndimin, të sigurojë garanci ta forta për të drejtat e pakicës kombëtare serbe. Le të lejojë që Kosova të hyjë në Unseko, gjë e cila do të garantojë përkujdesje për manastiret serbe. Le të bëhet Kosova antare e Interpolit në mënyrë që, nën çadrën e policisë botërore, shqiptarët dhe serbët të mbrohen nga kriminaliteti, i cili në këtë situatë është më efikas sepse – në ndryshim nga politikanët- ai nuk njeh ndarje nacionale.

Bashkimi European pas kësaj nuk do ta ketë të lehtë të refuzojë pranimin e antarëve të rinj me argumentin se ata (Serbia dhe Kosova) janë eksportues krizash dhe nuk e dinë se ku i kanë kufinj. Rajoni do të merrte frymë të lehtësuar. Në të kundërt mund të bëhet realitet paralajmërimi i ish ambasadorit amerikan në Beograd, Kameron Manter, sipas të cilit Serbia nuk rrezikon ndëshkimin, por mund të harrohet.

“As që më bëhet vonë për amerikanët, rusët, europianët e gjithë të tjerët. Do të marr vendime në përputhje me interesat e Serbisë edhe sikur të mbetesha i vetëm në këtë botë, jam zgjedhur nga populli e kështu që këto pesë vite do të marr vendime në përfitim të Serbisë dhe të qytetarëve të saj”, thotë Vuçiçi.

Qytetari Vuçiç mund ta veçojë vetveten, por presidenti Vuçiç nuk është zgjedhur për ta izoluar Serbinë. Pas një dhjetëvjeçari gërricjesh duhet shpejtuar dhe të shfrytëzohet me kurajo momenti për të marrë një mbështetje më të madhe nga ShBA-të dhe BE-ja, që Ballkani Perëndimor të përfshihet në një front të përbashkët kundër Putinit, i cili mund të përpiqet që nëpërmjet destabilizimit të rajonit të tërheqë vëmendjen nga Ukraina dhe nga lufta e atjeshme të cilën do të deshte ta përfundonte por nuk di sesi ta bëjë këtë.

Ekziston një mundësi e rrallë që të evitohet ashpërsimi me Perëndimin dhe njëkohësisht të ruhet dinjiteti: le të hyjë Kosova në Kombet e Bashkuara, ndërsa Serbia le ta mbajë qëndrimin se nuk ka asgjë nga njohja formale e ndërsjellë. Nëse Serbia do të vendoste që Kosovëq ti hapë rrugën për në OKB, atëherë do të mund të kërkonte që në bisedime ta arrihet marrëveshje për autonominë e serbëve, për pronat dhe monumentet e kulturës së atjeshme. Në të kundërt kurrfarë bisedimesh rreth këtyre temave nuk mund të ketë.

**Përktheu për Argumentum
Xhelal FEJZA**

Nga konflikti i Ukrainës tek ndryshimet klimatike, ja çfarë ndodhi në Davos

Takimi Vjetor i Forumit Ekonomik Botëror pa mbi 2,500 liderë globalë duke folur dhe diskutuar mbi tema që mbulojnë luftën Rusi-Ukrainë, ndryshimet klimatike, krizën ushqimore, tregtinë dhe globalizimin dhe më shumë.

India ishte në qendër të shumë dialogëve mbi çështjet në zhvillim, duke filluar nga teknologjitë e kriptove deri te ndryshimet klimatike. Më shumë se njëqind delegatë indianë që përfaqësojnë CEO, themelues të njëbrirëshit dhe udhëheqës politikë ishin në Davos.

“Për sa i përket numrave dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për qeverinë, ne kemi shifra rekord nga India,” tha Sriram Gutta, kreu i agjendës së Indisë në Forum. “Ne aktualisht punojmë me shumë shtete në nisma të ndryshme, duke përfshirë inovacionin ushqimor dhe teknologjinë bujqësore, prodhimin dhe prodhimin e avancuar, dronët dhe automjetet elektrike, ndër të tjera.”

Forumi Ekonomik Botëror (WEF) lançoi të hënën kapitullin e Indisë të Aleancës së Drejtuesve të Veprimit për Klimën CEO për të rritur veprimet e Indisë për klimën dhe përpjekjet për dekarbonizimin.

Ja çfarë ndodhi në Davos:

Lufta Rusi-Ukrainë

Me seanca të panumërta për ndikimin e vazhdueshëm të pushtimit rus, presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelenskyy dhe Ministria e Jashtme Dmytro Kuleba falënderuan komunitetin ndërkombëtar për mbështetjen e tyre.

Zelenskyy bëri thirrje për “sanksione maksimale” ndaj Rusisë, duke përfshirë ndalimin e të gjitha bankave ruse, një embargo ruse të naftës dhe ndalimin e të gjithë tregtisë me Rusinë.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg dhe kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, bënë thirrje për vazhdimësi të unitetit.

“Kjo nuk është një çështje e mbijetesës së Ukrainës. Nuk ka të bëjë me Evropën. Ka të bëjë me të gjithë komunitetin global. Ukraina duhet ta fitojë këtë luftë dhe agresioni i Putinit duhet të kundërshtohet dhe ne do të bëjmë gjithçka për ta siguruar këtë,” tha presidenti i BQE.

Mesazhi i kancelarit gjerman Olaf Scholz? Ne nuk mund të lejojmë që Rusia të fitojë këtë luftë.

Kriza e ushqimit dhe energjisë

Siguria ushqimore dhe energjetike dhe dy krizat e lidhura me luftën në Ukrainë ishin gjithashtu të larta në axhendë këtë vit.

Duke folur në Ditën 1 të Takimit Vjetor, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Fatih Birol tha se ishte kriza e parë e vërtetë globale e energjisë, ndërsa të mërkurën Dmytro Kuleba paralajmëroi se



Ukraina do të përballë me një krizë ushqimore shumëvjeçare nëse gjërat nuk ndryshojnë.

Duke iu drejtuar ngjarjes “India në 75: Perspektiva Strategjike”, ministri i Tregtisë Piyush Goyal tha se edhe pse sfidat vazhdojnë të mbeten në frontin ekonomik, qeveria indiane është e ndërgjegjshme për të ecur përpara dhe është e vetëdijshme se në çfarë të fokusohet.

Ndryshimi i klimës

E lidhur me energjinë është mjedisi dhe klima gjithnjë në ndryshim, por Birol tha se bota nuk duhet të ketë nevojë të zgjedhë mes krizës klimatike dhe asaj energjetike.

I dërguari i posaçëm presidencial i SHBA-së për Klimën, John Kerry nisi Koalicionin First Movers, një iniciativë globale që synon dekarbonizimin e industrisë së rëndë dhe sektorëve të transportit në distanca të gjata përgjegjëse për 30 për qind të emetimeve globale.

Kina është zotuar të mbjellë dhe të ruajë 70 miliardë pemë deri në vitin 2030, duke iu përgjigjur nismës WEF1t.org.

Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane, Christine Lagarde theksoi rolin vendimtar që duhet të luajë sektori privat dhe tha se është e rëndësishme që drejtuesit e biznesit dhe industrisë të përmbushin angazhimet e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane.

Ekonomia

Gjatë pesë ditëve, ekspertët diskutuan ndikimin e luftës në ekonominë globale. Gita Gopinath e FMN tha se lufta kishte qenë një ‘pengesë e madhe’ për rimëkëmbjen nga pandemia Covid-19.

Gopinath tha se ekonominë e përparuar do të kthehen në rrugën e duhur deri në vitin 2024, por ekonominë në zhvillim do të jenë 5 për qind më poshtë se ku do të kishin qenë ndryshe.

Panelistët diskutuan se rikuperimi nga kriza Covid-19 ka qenë thellësisht i pabarabartë brenda dhe midis vendeve, në varësi të aksesit të tyre në burimet fiskale dhe vaksinat.

Për sa i përket shëndetit

Ndikimi i vazhdueshëm i pandemisë Covid-19 ishte qendror për shumë diskutime dhe ne zhvilluam gjithashtu diskutime për përgatitjen për pandeminë e ardhshme, shëndetin mendor dhe barazinë shëndetësore.

Pfizer ka njoftuar se do të furnizojë të gjitha medikamentet dhe vaksinat e saj aktuale dhe të ardhshme të mbrojtura me patentë mbi një bazë jofitimprurëse në 45 vende me të ardhura më të ulëta dhe po flet me prodhuesit e tjerë të mëdhenj të barnave për hapa të ngjashëm.

Duke iu drejtuar një sesiioni mbi ‘Mbylljen e hendekut të vaksinave’, Ministri i Shëndetësisë Mansukh Mandaviya dha gjithashtu mbështetjen për Afrikën në rritjen e aftësisë kërkimore dhe zhvillimit të vendeve afrikane për kundërmasat mjekësore.

Si mund të ndikojë lufta në Ukrainë në tregjet në zhvillim?



LES NEMETHY*

Të gjithë kemi dëgjuar shprehjen se një flutur që përplas krahët në Amazonë mund të ndikojë në modelin e motit në anën tjetër të planetit. A mund të ketë edhe lufta në Ukrainë pasojë të tilla të padëshiruara?

Ndërsa jam i dëshpëruar në shkallën e katastrofës humanitare në Ukrainë, ky artikull eksploron mundësinë e efekteve të papritura dhe të paparashikueshme përtej kufijve të Ukrainës, duke përfshirë mundësinë që më shumë njerëz të vdesin nga uria në pjesë të tjera të botës sesa si pasojë e veprimeve ushtarake në Ukrainë.

Tre mekanizmat kryesorë të mundshëm të transmetimit për këtë efekt flutur përfshijnë: (a)

ndërprerjen e zinxhirëve të furnizimit, veçanërisht në bujqësi; (b) ndërprerjet e furnizimit me energji dhe (c) efektet monetare. Këto tendenca shpesh përforcojnë njëra-tjetrën. Të gjitha ishin duke u zhvilluar para luftës; lufta duket se i përkeqëson dhe katalizon këto efekte.

a, Ndërprerje e zinxhirëve të furnizimit, veçanërisht në bujqësi

Zinxhirët e furnizimit global ishin tashmë nën tendosje, pavarësisht nga lufta e Ukrainës, pjesërisht për shkak të Covid-19. Për shembull, 30% e kontejnerëve në botë tani janë në vend, duke pritur rreth porteve, për shkak të ndërprerjes, me shumicën e tyre të mbërthyer pranë Shangait, të mbyllur nga Covid.

Lufta e Ukrainës shton një dimension të madh shtesë në sfidat e anës së ofertës, veçanërisht

është në lidhje me bujqësinë. Siç tregon grafiku i mëposhtëm, Rusia, Ukraina dhe Bjellorusia përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të prodhimit të mallrave kryesore bujqësore.

Për t'i bërë gjërat edhe më keq, një përqindje shumë e madhe e eksporteve të sipërpërmendura shkojnë në tregjet në zhvillim. Vende të tilla si Libani dhe Egjipti (importuesi më i madh në botë i drithit), si dhe i gjithë rajoni sub-Saharian, janë shumë të varur nga eksportet ruse dhe ukrainase. Por edhe në sferën e mikroçipave – a e dini se dy fabrika ukrainase që furnizonin neon për prodhimin e lazerëve që prodhojnë mikroçipe u mbyllën për shkak të luftës?

b, ndërprerje të furnizimit me energji

Lufta e Ukrainës ka përforcuar më tej shtrëngimin në tregjet e naftës dhe gazit – gjë që ka pa-

sur një efekt të konsiderueshëm në çmimet e hidrokarbureve në nivel global, veçanërisht në Evropë. Duke pasur parasysh se plehurat e amoniumit bëhen nga gazi dhe pothuajse 40% e eksporteve globale të potasës nga Rusia dhe Bjellorusia (siç tregohet në grafikun e mësipërm), bota do të shohë një reduktim të mprehtë të përdorimit në vitin 2022. Shumë prodhues të amoniumit, duke përfshirë edhe më të mëdhenjtë në Hungari, kanë ndërprerë prodhimin total, për shkak të luhatshmërisë së çmimeve të energjisë.

Nëse fermerët nuk përdorin pleh, ata do të shohin rënien e rendimentit; nëse përdorin pleh, ata do të duhet të kalojnë përmes kostove të inputeve. Sido që të jetë, presioni mbi çmimet e bujqësisë do të përshpejtohet. Edhe pse grafiku i mëposhtëm tregon rritje masive të çmimeve të bujqësisë, për mendimin tim ky proces i rritjes së çmimeve bujqësore ka ende një rrugë të gjatë për të bërë.

Rritja e çmimit të energjisë ka gjithashtu një efekt negativ në rritjen e PBB-së dhe një efekt të përgjithshëm inflacionist. Shumica e recesioneve të pasluftës përkoi me rritjen e çmimit të energjisë.

c, Efektet monetare

Çështjet e sipërpërmendura të zinxhirit të furnizimit dhe rritjet e çmimeve të mallrave kanë kontribuar të gjitha në përshpejtimin e inflacionit. Kjo, nga ana tjetër, ka mobilizuar disa banka qendrore drejt shtrëngimit monetar. Është shkruar shumë për vështirësinë që bankat qendrore do të kenë në uljen e inflacionit pa shkaktuar recesion, ndërkohë që ato synojnë “uljen e butë” të fabuluar. Asnjëherë nuk janë kuruar nivelet aktuale të in-

“

Sa herë që SHBA rrit normat e interesit, tregjet në zhvillim vuajnë shumë, pasi ato janë të detyruara të rrisin normat e interesit me të paktën aq shumë, për të shmangur daljet e kapitalit. Shumë vende në zhvillim tashmë janë detyruar të rrisin ndjeshëm normat e interesit dhe përsëri, sipas mendimit tim, tendenca do të shkojë më tej. Shërbimi i borxhit po bëhet gjithnjë e më i vështirë. Sri Lanka tashmë ka dështuar. Pakistani dhe Peruja, gjithashtu me borxhe të larta, kanë përjetuar shpërthime dhune ose protesta masive. Bankat e tregjeve në zhvillim janë shumë të ekspozuara ndaj borxhit sovran (zakonisht obligacioneve të qeverive të tyre kombëtare)

flacionit pa shkaktuar një recesion. Problemet e vazhdueshme të Covid-it (dhe bllokimet e lidhura) dhe lufta e Ukrainës (dhe sanksionet e lidhura) ndërlikojnë më tej përpjekjet e bankave qendrore – për të përdorur shprehjen – si marrja e një develope nga vrima e gjilpërës.

Kryetari Powell i Fed-it të SHBA-së, ka njoftuar synimin e tij për të kryer atë që do të përbënte shtrëngimin më të rëndë monetar që nga fillimi i viteve 1980. Kjo ka të ngjarë të kërkojë rritjen e thesarit 10-vjeçar nga nën 3% në mbi 5%.

Sa herë që SHBA rrit normat e interesit, tregjet në zhvillim vuajnë shumë, pasi ato janë të detyruara të rrisin normat e interesit me të paktën aq shumë, për të shmangur daljet e kapitalit. Shumë vende në zhvillim tashmë janë detyruar të rrisin ndjeshëm normat e interesit dhe përsëri, sipas mendimit tim, tendenca do të shkojë më tej.

Shërbimi i borxhit po bëhet gjithnjë e më i vështirë. Sri Lanka tashmë ka dështuar. Pakistani dhe Peruja, gjithashtu me borxhe të larta, kanë përjetuar shpërthime dhune ose protesta masive.

